



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI  
KRYETARI

Nr. 50 Prot.

Tiranë, më 01/10/2024

**Lënda:** Caktim i përfaqësuesve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi pranë Grupit të Ekspertëve të Nivelit të Lartë në Komisionin e Posaçëm Parlamentar “Për thellimin e reformave për mirëqeverisjen, sundimin e ligjit dhe antikorrupsionin për Shqipërinë 2030 në Bashkimin European”.

Drejtuar:

Z. FATMIR XHAFAJ  
KUVENDI I SHQIPËRISË  
KOMISIONI I POSAÇËM PARLAMENTAR

TIRANË

I nderuar Z. Xhafaj,

Në vijim të shkresës Tuaj nr. 3025, datë 31.07.2024, me të cilën parashtrohet kërkesa për të caktuar një gjyqtar ose prokuror, anëtarë të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi (KED), si anëtarë të nëngrupit të veçantë pranë Grupit të Ekspertëve të Nivelit të Lartë në Komisionit të Posaçëm Parlamentar “Për thellimin e reformave për mirëqeverisjen, sundimin e ligjit dhe antikorrupsionin për Shqipërinë 2030 në Bashkimin European”, dëshiroj t’Ju vë në dijeni se, nisur nga fakti se KED është një organ kolegjal, kërkesa Juaj do t’i parashtrohet për diskutim mbledhjes së radhës së KED për një vendimmarrje kolegjiale.

Gjithashtu dëshiroj t’Ju vë në dijeni, se me qëllim adresimin e disa problematikave që kanë rezultuar gjatë zbatimit të kuadrit ligjor lidhur me organizimin dhe funksionimin e KED, KED 2024 ka hartuar dhe është duke diskutuar disa amendamente në ligjin 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të cilat do t’Jua vemë në dispozicion Komisionit të drejtuar nga Ju për vlerësim.

Përfitoj nga rasti për t’Ju shprehur konsideratën time më të lartë si dhe për t’Ju siguruar gadishmërinë dhe angazhimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, si një nga organet e larta drejtuese të sistemit të drejtësisë, për të dhënë kontributin e saj në punën e këtij Komisioni.

Me respekt,

KRYETARI


SOKOL NGRESI



Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2024

Adresa Postare : GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.

Adresa Elektronike : [info@ked.gov.al](mailto:info@ked.gov.al) Numra telefonikë : +355 4 2257302



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI  
KRYETARI

Nr. 51 prot.

Tiranë, më 01 / 10 / 2024

Lënda: Caktim i përfaqësuesve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi në Nëngrupin e Veçantë pranë Grupit të Ekspertëve të Nivelit të Lartë pranë Komisionit të Posaçëm Parlamentar “Për thellimin e reformave për mirëqeverisjen, sundimin e ligjit dhe antikorrupsionin për Shqipërinë 2030 në Bashkimin European”.

Drejtuar:

Z. FATMIR XHAFAJ  
KUVENDI I SHQIPËRISË  
KOMISIONI I POSAÇËM PARLAMENTAR

TIRANË

I nderuar Z. Xhafaj,

Në vijim të shkresës Tuaj nr. 3025, datë 31.07.2024, me të cilën parashtrohet kërkesa për të caktuar nga stafi administrativ i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, si anëtarë të Sekretariatit Teknik pranë Grupit të Ekspertëve të Nivelit të Lartë në Komisionit të Posaçëm Parlamentar, ju vë në dijeni se në përbërje të këtij Grupi, si përfaqësues të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, janë caktuar këshilltarët ligjorë, znj. **Aulona Bodo** (me detaje kontakti – email: [aulona.bodo@gjykataelarte.gov.al](mailto:aulona.bodo@gjykataelarte.gov.al) dhe tel: 0682155679) dhe z. **Miran Kopani** (me detaje kontakti – email: [miran.kopani@gjykataelarte.gov.al](mailto:miran.kopani@gjykataelarte.gov.al) dhe tel: 0696032234).

Përfitoj nga rasti për t’Ju shprehur konsideratën time më të lartë si dhe për t’Ju siguruar gadishmërinë dhe angazhimin e KED, si një nga pesë organet e larta drejtuese të sistemit të drejtësisë, për të dhënë kontributin e tij në punën e këtij Komisioni.

Me respekt,

KRYETARI

SOKOL NGRESI



Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2024

Adresa Postare : GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.

Adresa Elektronike : [info@ked.gov.al](mailto:info@ked.gov.al) Numra telefonikë : +355 4 2257302